



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS KAMENICË

---

Numri i lëndës: 2021:010569

Datë: 11.05.2021

Numri i dokumentit: 01770968

P.nr.10/21

**NË EMËR TË POPULLIT**

Gjykata Themelore në Gjilan - Dega në Kamenicë, gjyqtari Sadri Krasniqi, me sekretaren juridike Tevide Thaqi, në lëndën penale kundër të akuzuarit: S.M. nga ....., Lagjia .....", për shkak të veprës penale: Dhunë në familje nga neni 248, paragraf 3, nën paragraf 3.1 dhe 3.2, të KPRK-së, sipas aktakuzës së PTH-së nga Gjilani PP.II.nr.42/2021, të dt. 20.01.2021, në seancën e shqyrtimit fillestar të mbajtur më 05.05.2021, në prani të Prokurores së Shtetit Huma Jetishi dhe të akuzuarit S.M., shpalli dhe publikisht komunikoi, ndërsa më datën 11.05.2021 përpiloi këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I a k u z u a r i :**

**S.M.**, pa pseudonim dhe emër të rrejshëm, nga i ati Q., e ëma N., mbiemri i vajzërisë R., i lindur ....., në fsh. B., me vendbanim në ..... me nr. personal ....., Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i martuar, prind i dy fëmijëve, ka të kryer shkollën fillore, i pa punësuar, i gjendjes së varfër ekonomike, në bazë të evidencës që disponon kjo gjykatë nuk ka qenë i dënuar më parë.

**Ë s h t ë f a j t o r**

Sepse,

Më datë 15.12.2020, rreth orës 19:45min, në Lagjen ....., në shtëpinë familjare, i pandehuri me dashje dhe me qëllim të ushtrimit të pushtetit dhe kontrollit, cenimit të dinjitetit tek të dëmtuarat gruaja N. dhe vajza Sh. M. ka ushtruar dhunë në familje, në kundërshtim me nenin 2, nën nparagraf.2, të Ligjit për Dhunë në Familje, në atë mënyrë që sapo kthehet në shtëpi

pasi kishte konsumuar alkool, fillon të bërtasë dhe ta ofendojë me fjalë të ulëta vajzën e tij të dëmtuarën Sh., e cila i kërkon të pushojë por kjo e revolton akoma më tepër të pandehurin i cili tenton disa herë ta sulmojë fizikisht dhe në një moment e kap për beli duke shtrënguar fortë me ç`rast nga dhimbja e njëjta bërtet, e që më pas e dëmtuara N. për ta larguar nga vajza, por i pandehuri edhe atë e godet me dorë në ballë që si pasojë e goditjes e dëmtuara përplasat për enëlarësen e kuzhinës, ndërsa i pandehuri vazhdon të bërtasë dhe t'i përulë me fjalë të ulëta të dëmtuarat, me ç`rast i pandehuri me veprimet e tija pos që ka cenuar rëndë dinjitetin e të dëmtuarave, u ka shkaktuar dhembje, frikë dhe shqetësim të madh emocional.

- me ç`rast ka kryer veprën penale: Dhunë në Familje nga neni 248, parag. 3, nën parag 3.1 dhe 3.2 të KPRK-së

Gjykata në bazë të nenit të lartcekur dhe neneve 4, 38, 42, 43, 44, 69, 70 dhe 71 të KPRK-së, lidhur me nenet 248, 365 dhe 451 të KPRK-së, të akuzuarin S.M. e,

## G J Y K O N

Me dënim kumulativ:

- dënim me **gjobë** (në të holla) në shumë prej **200 €**, (**dyqindë euro**), të cilën shumë ka për ta arkëtuar në afat prej 30 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në të kundërtën dënimi me gjobë do t'i zëvendësohet me dënim me burg, ashtu që për çdo 20 €, do t'i llogaritet nga një ditë burgu, dhe

- dënim me **burg** efektiv, në kohëzgjatje prej **30 (tridhjetë) ditëve**, i cili dënim me pëlqimin e të akuzuarit, e në kuptim të nenit 44 të KPRK-së do t'i zëvendësohet në dënim me gjobë në shumë prej **300 €**, të cilën gjobë i akuzuari do ta arkëtoi në afat prej 30 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimit, në të kundërtën dënimi me gjobë do t'i zëvendësohet me dënim me burg, ashtu që për çdo 20 €, do t'i llogaritet nga një ditë burgu.

Të dëmtuarat N. M. dhe Sh. M. që të dyja nga ....., nuk i bashkëngjiten ndjekjes penale dhe nuk kërkojnë kompensim materialo juridik.

Detyrohet i akuzuari S.M., që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 €, krejt këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi me kanosje përmbarimi.

## A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjilan, me aktakuzën PP.II.nr.42/2021, të dt. 20.01.2021, ka kërkuar që ndaj të akuzuarit: S.M. nga ....., të fillohet dhe shtjellohet procedura penale, për shkak të veprës penale: Dhunë në Familje nga neni 248, parag3, nënparag 3.1 dhe 3.2, të KPRK-së, të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit.

Gjykata shqyrtoi aktakuzën dhe pas vlerësimit të së njëjtës dhe shkresave tjera të lëndës konstatoi se aktakuza është e bazuar në ligj, andaj duke vepruar sipas të njëjtës, ka caktuar seancë gjyqësore për shqyrtim fillestar kundër të akuzuarit për dat.05.05.2021, në të cilën seancë gjyqësore pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurores së shtetit, i akuzuari S.M.ka deklaruar se e ka kuptuar aktakuzën dhe veprën penale për të cilën akuzohet, njëherit thekson se e pranon fajësinë për kryerjen e kësaj vepre penale.

Në shqyrtimin fillestar dhe publik, gjykata pas dëgjimit të palëve ka marrë aktvendim me të cilin ka pranuar pranimin e fajësisë, ngase ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë. Në këtë aspekt, gjykata ka konstatuar se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë; se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga i akuzuari, se pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza dhe aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Andaj, duke u bazuar në të cekurat më lartë, gjykata e ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

- se i akuzuari S. M. me dashje ka kryer veprën penale: Dhunë në Familje nga neni 248, parag3, nënparag 3.1 dhe 3.2, të KPRK-së, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitivin e këtij aktgjykimi, për të cilën vepër penale, gjykata të akuzuarin e shpalli fajtor, ngase veprimet e të njëjtit i përmbajnë të gjitha tiparet e kësaj vepre penale dhe se për të njëjtën është edhe penalisht përgjegjës.

Me rastin e vendosjes për llojin dhe lartësinë e dënimit ndaj të akuzuarit për veprën penale të kryer, gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat të cilat në kuptim të nenit 70 të KPRK-së, ndikojnë në shqiptimin e drejtë dhe meritore të dënimit ligjor. Në veçanti për këtë rast si rrethana lehtësuese për të akuzuarin gjykata pati parasysh pranimin e fajësisë nga i akuzuari, është penduar thellë për veprën penale të kryer, të dëmtuarave i`u kërkon falje publike, është hera e parë që ka ra ndesh me ligjin, gjendjen e tij të vështirë vështirë ekonomike, si mbajtës i familjes dhe me probleme shëndetsëre jeton pa kurrfarë të ardhura, si dhe premtimin e tij se në

të ardhmen nuk do të kryej vepër tjetër penale. Ndërsa gjykata nuk gjeti ndonjë rrethanë rënduese për të akuzuarin.

Sipas bindjes së gjykatës, dënimet me gjobë dhe me burg, si në dispozitiv të aktgjykimit ndaj të akuzuarit S. M., duke i marrë për bazë rrethanat e përmendura më lartë, janë dënime të drejta, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë të akuzuarit.

Gjykata, gjithashtu ka konstatuar se me këtë dënim, mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit nga neni 38 i KPRK-së, i cili konsiston në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij; të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Të dëmtuarat N.M. dhe Sh. M. që të dyja nga ....., nuk i bashkëngjiten ndjekjes penale dhe nuk kërkojnë kompensim materialo juridik.

Duke pasur parasysh natyrën e kësaj çështje penale dhe gjendjen financiare të akuzuarit, gjyqtari i vetëm gjykues, bazuar në nenin 451 paragrafi 1 i KPPRK-së, ka vendosur që të akuzuarin ta detyrojë për ta paguar paushallin gjyqësor në shumën prej 20 € (Njëzetë euro), në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi me kanosje përmbarimi.

Nga të cekurat më lartë është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN- DEGA NË KAMENICË,

P.nr. 10/2021 më datë. 11.05.2021

Gj y q t a r i,

SadriKrasniqi,d.v.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të aktgjykimit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.